



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 6860/2330/346

Dt. Regj. 05.09.2014

Dt. Vendimi 23.03.2016

V E N D I M

“Për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore”

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë prej:

Kryesues: Kastriot SELITA
Anëtare: Rilinda SELIMI
Anëtare: Altina NASUFI

me sekretare gjyqësore [REDACTED] në Tiranë, sot më datë 23.03.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 6860/2330/346 akti, dt. Regjistrimi 05.09.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITES: Albchrome shpk, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar rregjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit me NIPT [REDACTED]

I PADITUR: 1. Bashkia Bulqize Sektori i Tatim Taksave.

2. Keshilli Bashkiak i Bashkise Bulqize.

OBJEKTI: Shperblimin e demit te shkaktuar nga diskriminimi duke kthyer tarifen e pastrimit te paguar me teper krahasuar me personat e tjere juridik ne fushen e prodhimit te kromit percaktuar me vendimet nr 55 date 22.10.2010, nr 45 date 12.12.2011 dhe nr 48 date 11.12.2012 te Bashkise Bulqize ne shumen totale 8 850 000 leke.

Pagimin e demit jopasuror shkaktuar nga diskriminimi ne shumen 1 770 000 leke.

Ngarkimin e te paditurit me pagimin e shpenzimeve gjyqesore dhe avokatore te parapaguara nga paditesi.

BAZA LIGJORE: Ligji nr 10221 date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi” nenet 31, 32, 153, 154 e vijues i K.Pr.Civile.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. 2623, datë 23.05.2014 ka vendosur:

1. Rrezimin e kerkese padise se paditesit shoqeria Albchrom shpk si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim pales paditese...”

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, pala paditese Shoqëria AlbChrome sh.p.k., me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padise, për shkaqet:

- Arsyetimi dhe argumentet e dhena nga Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë janë teresisht të gabuara dhe haptazi në keqinterpretim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" dhe të Kodit Civil.
- Paraprakisht theksojmë se në aspekt procedural nga Gjykata nuk është zbatuar neni 36, pika 3 dhe 4, e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" që parashikon se: "3. Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim. Gjykata mund t'i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është here hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen."
- Njoftimi i Komisionerit, sipas dispozites me sipër, është i detyrueshëm dhe nuk lihet në çmimin e gjyqesës. Madje edhe marrja e mendimit të Komisionerit gjykojmë se është një domosdoshmëri për sa kohë që ai është organ posaçërisht i specializuar në trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe raste të tilla janë të reja për sistemin gjyqësor.
- Se dyti, arsyetimi i gjyqesës së shkallës së parë që paditësi është favorizuar në pagimin e tarifës së pastrimit duke iu percaktuar një tarifë me e ulët është haptazi i pambeshtetur në legjislativën fiskal perkates. Gjykata shpesh here në arsyetimin e vendimit objekt kundërshtimi ngatëron konceptin e "taksës vendore" me atë të "tarifës vendore", të cilat rregullohen nga dispozita të ndryshme në Ligjin 9632/06. Taksat rregullohen nga Kreu IV i Ligjit 9632/06 nënë 20-33 ndërkohe që tarifën nga Kreu VII (neni 35 i të njëjtit ligj).
- Në rastin konkret, arsyetimi i gjyqesës, i cili mbështet teresisht parashtrimet e palës së paditur, ndoshta mund të vlejë për rastin e taksës së zënies së hapësirës publike për biznes, e cila rregullohet nga neni 32, i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i cili parashikon se: "Keshilli Bashkiak... vendos: ... 2. Në rastin e taksës për zënie hapësirave publike për qëllim biznesi: a. taksat llogariten si detyrim mujor i taksapaguesit; b. baza e taksës shprehet në meter katror sipërfaqe publike të zënies; c. niveli i taksës jepet në aneksin 6 të ligjit (që është 60 leke/m²); ç. Keshilli i komunes apo bashkisë në kufijtë plus 10%/ minus 30% të nivelit tregues të taksës, mund të caktojë nivele të ndryshme të taksës...; d. taksa për zënie hapësirave publike nuk mund të vendoset për hapësira që nuk janë në pronësi apo administrim të pushtetit vendor".
- Edhe kjo taksë do të mund të aplikohet vetëm nëse i padituri do të provonte që kishte në pronësi apo administrim sipërfaqen me sipër (në kuptim të germes (d) cituar këtu me sipër). Ky nuk është rasti ynë pasi jemi para një pasurie publike (miniere) që është prone e shtetit dhe për të cilën paditësi disponon leje koncesionare.
- Se treti, në rastin konkret, referuar edhe tre vendimeve të Keshillit Bashkiak të Bashkisë Bulqizë permendur me sipër, jemi para një tarifë (asaj të pastrimit) dhe jo taksës për zënie hapësirave publike për biznes siç arsyeton gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar.
- Tarifën rregullohen nga neni 35 i Ligjit 9632/06 i cili parashikon se: "1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur: a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"; b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjohet e lidhur me to, në përputhje me këtë ligj." si dhe nga pika 3, e nenit 16, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i cili percakton se: 3. Komuna dhe bashkia krijojnë të ardhura nga tarifën vendore për: a)

- sherbimet publike qe ato ofrojne. Ne rastin tone paditesit i eshte vene nje tari fe pikerisht per nje sherbim, ate te pastrimit, ofruar nga Bashkia Bulqize.
- Ne rastin konkret jemi haptazi para nje sjellje (veprimi) diskriminuese te administrates vendore. Te paditurit nuk kane dhene asnje shkak te ligjshem apo arsyetim te mbeshtetur ne rrethana faktike dhe objektive se perse justifikohet per paditesin nje tarife pastrimi 22 here me e madhe krahasuar me cdo subjekt tjeter qe operon ne te njejten fushe apo perse kio tarife rritet cdo vit afersisht me 10% vetem per paditesin, nderkohe qe ka rreth 10 vjet qe mbetet e pandryshuar per te gjithë subjektet e tjere te se njejtës fushe.
 - Neni 3 "Perkufizimet", pika 2, i ligjit nr. 10221, parashikon shprehimisht se: *"Diskriminim i drejtperdrejte eshte ajo forme diskriminimi qe ndodh kur nje person apo grup personash trajtohen ne menyre me pak te favorshme sesa nje person tjeter, apo nje grup tjeter personash ne nje suate te njejtë a te ngjashme, ..."*. Me tej neni 7, pika 1 i te njejtit ligj parashikon: *"Çdo veprim ... i autoriteteve publike ..., qe krijojne baza per mohimin e barazise ndaj nje personi apo grupi personash, ose qe i ekspozon ata ndaj nje trajtimi te padrejte dhe jo te barabarte, kur ata ndodhen ne rrethana te njejtë ose te ngjashme, ne krahasim me persona te tjere ose grupe te tjera personash, perben diskriminim"*.
 - Qellimi i ligjit nr. 10221 eshte t'i siguroje çdo personi te drejten per barazi para dhe mbrojte te barabarte ligjit (neni 2, germa "a") si dhe per mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo sjellje qe nxit diskriminimin (neni 2, germa "c").
 - Per sa me siper, ne rastin konkret jemi para rastit te diskriminimit nga organet publike vendore te subjekteve juridike qe jane ne rrethana te njejtë, pra operojne ne te njejtën fushe te industries, por qe ju aplikohet tarife vendore e ndryshme per te njejtin sherbim public, ate te pastrimit.
 - Per me teper, tarifat nga keshillat bashkiake duhet te percaktohen ne menyre normative e abstrakte dhe jo individuale e nominale si ne rastin konkret: nje veprim i tille deshmon sjelljen diskriminuese. Percaktimi i tarifës nuk duhet te lidhet me emrin e subjektit prodhues ne fushen e kromit por duhet te mbeshtetet ne kritere objektive dhe reflektoje nevojën per sherbimin e pastrimit si dhe duhet te ruhet proporcionaliteti me operatorët e tjere te se njejtës industry. Eshte e pakonceptueshme qe vetem nje subjekt i percaktuar nominalisht mes gjithë subjekteve te tjere qe ushtrojne te njejtën veprimtari te shkaktoje nje ndotje te tille sa te justifikojë nje tarife pastrimi te pakten 22-fish me te larte krahasuar me te gjithë subjektet e tjere pa perjashtim qe tarifohen simbolikisht.
 - Edhe rritja e tarifës ne fjale nga viti ne vit 10% apo me shume, nderkohe qe per te gjithë subjektet e tjere te prodhimit te kromit mbetet e pandryshuar prej shume vitësh thjesht perben nje prove me shume per ekzistencën e diskriminimit dhe thellimin e tij nder vite.
 - Rrjedhimisht, tarifa e pastrimit per paditesin, duhej te aplikohet ne te njejtin nivel qe aplikohet per te gjithë kategorine abstrakte te subjekteve te tjere juridike ne fushen e nxjerrjes dhe prodhimit te kromit ku ben pjese dhe paditesi, per te cilat tarifa vjetore e pastrimit eshte dukshem me e ulet.
 - Per me teper, paditesit nuk i ofrohet efektivisht asnje sherbim pastrimi. Te gjitha mbeturinat nga aktiviteti qe ushtron ai i largon nepermjet shoqerive te kontraktuara drejtperdrejt prej tij.
 - Ne baze te nenit 53(b) te ligjit nr. 49/2012, kerkojme nga Gjykata e Apelit Administrativ Tirane, qe çeshtja te gjykohet ne seance gjyqesore duke bere keshtu nje shpjegim me te

qarte nga ana jone te detajeve te siperpermendura. Kjo edhe per vete faktin qe jemi para çeshtjeve te tilla qe gjykohen per here te pare.

- Per sa me siper, i kerkojme gjykates te pranoje padine duke vendosur: 1. Ndryshimin e vendimit nr. 2623 date 23.05.2014, te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane; 2. Te detyroje te paditurit te kthejne pagesat e tarifes se pastrimit te paguar me teper ne raport me personat e tjere juridike ne fushen e prodhimit te kromit, sipas vendimeve te Keshillit Bashkiak nr. 55, date 20.12.2010, nr. 45, date 12.12.2011 dhe nr. 48, date 11.12.2012, te Bashkise Bulqize ne shumen 8.850.000 Leke; 3. Te ngarkoje te paditurin me pagimin e demit jo pasuror (moral) ne shumen 1.770.000 Leke; 4. Te ngarkoje te paditurin me pagimin e shpenzimeve gjyqesore dhe avokatore te parapaguara nga paditesi.

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e **gjyqtares Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çeshtjen ne tërësi;

V Ë R E N

Pala paditëse Shoqeria Albchrome shpk eshte person juridik i krijuar me date 14.04.2000 me objekt veprimtarie sipas ekstraktit të QKR: nxjerrje kromite ne minierat e kromit ne Bulqize, Prrenjas (Librazhde) dhe Pojska (Progradec), te riaktivizojë, seleksionojë, perpunojë dhe pasurojë kromitet ne Impiantet e Pasurimit dhe Seleksionimit te Kromit ne Bulqize dhe Klos, dhe te prodhojë Ferro-Krom ne Uzinat e Ferrokromit Elbasan dhe Burrel, duke perdorur know how dhe minierat, impiantet dhe uzinat/fabrikat e Ortakut. Shoqeria do te zhvillojë edhe keto aktivitetet: rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytezimin e minierave, impianteve dhe uzinave/fabrikave.

Aktiviteti i shoqërisë në Bulqizë është objekt i detyrimeve vendore. Objekt i mosmarrëveshjes lidhet pikërisht me përcaktimin e vlerës së tarifës së pastrimit me vendimet e Këshillit Bashkiak Bulqizë. Kështu rezulton se:

Me ane te vendimin nr. 55 date 22.10.2010, "Per miratimin e paketes fiskale te taksave dhe tarfiva e vendore" per vitin 2011 Keshilli Bashkiak i Bashkise Bulqize ka përcaktuar ndër të tjera që vlera e tarifës së pastrimit për palën paditese shoqeria Albchrom është në shumën prej 3 000 000 lekë.

KJo vlerë rezulton të jetë përcaktuar dhe në paketën fiskale të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2012, miratuar me vendimin nr. 45 datë 12.12.2011, ndërsa për vitin 2013 vlera e saj është në shumën 3.300.000 lekë, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 48 datë 11.12.2012.

Me shkakun se është diskriminuar dhe trajtuar vecmas nga subjektet e tjerë të prodhimit të kromit lidhur me vlerën e tarifës së pastrimit për vitet 2010, 2011 dhe 2012, pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me objekt kërkimi "shperblimin e demit te shkaktuar nga diskriminimi duke kthyer tarifen e pastrimit te paguar me teper krahasuar me personat e tjere juridik ne fushen e prodhimit te kromit percaktuar me vendimet nr. 55 date 22.10.2010, nr 45 date 12.12.2011 dhe nr 48 date 11.12.2012 te Bashkise Bulqize ne shumen totale 8 850 000 leke. Pagimin e demit jopasuror shkaktuar nga diskriminimi ne shumen 1 770 000 leke si dhe ngarkimin e te paditurit me pagimin e shpenzimeve gjyqesore dhe avokatore te

parapaguara nga paditesi.

Në bazë të vendimit nr. 67, datë 05.03.2014 kjo gjykatë ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e kësaj mosmarrëveshje administrative dhe çështja është dërguar për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Sipas palës paditëse kërkimet objekt padie janë të bazuara me argumentimin se:

- "Tarifat e pastrimit" është percaktuar (ne rritje) ne menyre individuale (nominale) per Albchrome, per vitet ne fjale, pagesa e tarifes se pastrimit perkatesisht ne shumat 3.000.000 leke, 3.000.000 leke dhe 3.300.000 leke, ku po ne kete pike per subjektet e tjere juridike te nxjerrjes e prodhimit te kromit, qartesisht është percaktuar tarifa 150.000 leke ne vit, e cila ka mbetur e pandryshuar per te tre vitet me siper, madje edhe me pare, dhe qe është afersisht 22 here me e ulet.
- Pra, shohim qe Keshilli Bashkiak i Bashkise Bulqize ka percaktuar nominalisht per paditesin nje tarife pastrimi e cila është dukshem me e larte (afersisht 22-fish me e larte) krahasuar me te gjithë subjektet e tjere juridike qe operojne ne te njejten fushe, konkretisht ne ate te nxjerrjes dhe prodhimit te kromit.
- Per sa me siper, ne rastin konkret jemi para rastit te diskriminimit nga organet publike vendore te subjekteve juridike qe jane ne rrethana te njejta, pra operojne ne te njejten fushe te industrise, por qe iu aplikohet tarife vendore e ndryshme per te njejtin sherbim publik, ate te pastrimit.
- Per me teper, akti qe miraton tarifat nga keshillat bashkiake duhet te jete normativ e abstrakt dhe jo individual e nominal si ne rastin konkret, pasi nje veprim i tille e ben aktin diskriminues. Percaktimi i tarifes nuk duhet te lidhet me emrin e subjektit prodhues ne fushen e kromit, por duhet te mbeshtetet ne kriteret objektive dhe reflektoje nevojën per pastrimit mbeshtetur ne nivelin e ndotjes qe nje prodhues shkakton dhe duhet te ruhet proporcionaliteti me operatorët e tjere te se njejtes industri. Eshte e pakonceptueshme qe vetem nje subjekt i percaktuar nominalisht mes gjithë subjekteve te tjere qe ushtrojne te njejten veprimtari te shkaktoje nje ndotje te tille sa te justifikojte nje tarife pastrimi te pakten 22-fish me te larte krahasuar me te gjithë subjektet e tjere qe tarifohen simbolikisht.
- Per me teper, verejme qe per paditesin tarifa rritet nga viti ne vit 10% apo me shume, nderkohe qe per te gjithë subjektet e tjere te prodhimit te kromit mbetet e pandryshuar prej shume vitesh te njepasnjeshem.
- Qellimi i ligjit nr. 10221 është t'i siguroje çdo personi te drejten per barazi dhe mbrojte te barabarte para ligjit (neni 2, germa "a") si dhe per mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo sjellje qe nxit diskriminimin (neni 2, germa "c").

Pala e paditur ka kërkuar rrëzimin e padisë me pretendimet se:

- Vendimet e Keshillit Bashkiak te Bashkise Bulqize me nr. 55, date 20.12.2010, nr. 45, date 12.12.2011 dhe nr. 48, date 11.12.2012 jane marre ne unanimitet dhe te gjithë vendimet i jane derguar per konfirmim Prefektures se Qarkut Diber, e cila ka dhene miratimin per ligjshmerine e tyre;
- 2. Paditesi çdo vit i ka paguar taksat rregullisht pa i kundërshtuar ato;
- 3. Administratori si dhe disa punonjes te Albchrome kane qene te pranishem dhe kane dhene miratimin e tyre per vendimet e Keshillit Bashkiak te Bashkise Bulqize, ne cilesine

- e anetareve ne kete keshill;
- 4. Paditesi eshte i favorizuar pasi tarifa ne fakt eshte percaktuar sa 5% te shumes reale (me saktesisht: $920.000 \text{ m}^2 \times 60 \text{ leke/m}^2 = 662.400.000 \text{ leke}$) qe duhej te paguajc nese tarifa llogaritet per te gjithë siperfaqen ku paditesi ushtron aktivitetin.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. 2623, datë 23.05.2014 ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se:

"...Ne nenin 32 te ligjit nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" parashikohet se taksa per zenien e hapesires publike per qellime biznesi llogariten si detyrime mujore te taksapaguesve. BAze e takses shprehet ne meter kator siperfaqe publike te zene.Niveli treguesi takses jepet ne aneksin 6 te ketij ligji .

Sipas ankesit 6 te ketij ligji BAshkia e Bulqizes perfshihet ne kategoria e trete dhe niveli I takses eshte 600 leke per m2 ne muaj .

Sipas pohimeve te perfaqesueses se pales se paditur BAshkia Bulqize siperfaqja qe ka ne perdorim pala paditese eshte 0.92 km2 .Ky fakt nuk u kundërshtua prej perfaqesuesit te pales paditese.Pra sipas rregullimet e mesiperme ligjore tarifa e pastrimit qe duhet te paguante paditesi eshte ne Shumen 662 400 000 leke ($0.92 \text{ km}^2 \times 12 \times 600 = 662 400 000$)

Perfaqesuesit e pales paditese shoqeria Albchrom shpk pretenduan se tarifa e pastrimit e vendosur nga ana e pales se paditur eshte diskriminuese pasi ajo eshte me e larte per kete shoqeri ne krahasim me subjektet e tjera qe operojne ne te njejten fushe dhe ne kushte te ngjashme.

Neni I i ligjit nr 10221 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" parashikon se "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimi te barazisë ne lidhje me gjininë , racën ngjyrën etninë , gjuhen, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore , shtatzaninë ,përkatësinë prindërore ,përgjegjësinë prindërore moshën , gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë ne një grup te veçantë ose me çdo shkak tjetër" .

Sipas neni 3 paragrafi 1 po te ketij ligji fenomeni i diskriminimit përkufizohet:

"Diskriminim është çdo dallim,përrjashtim , kufizim apo preference, bazuar ne cilindo shkak te përmendur ne neni 1 te ketij ligji, qe ka si qellim apo pasoje pengesën apo bërjen e pamundur te ushtrimit ne te njëjtën mënyrë me te tjerët , te te drejtave e lirive themelore te njohura me Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë , me aktet ndërkombëtare te ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ,si dhe me ligjet ne fuqi" .

Pra shkëlja e parimit baze te barazisë se shtetasve, eshte kushti i vetëm dhe i mjaftueshëm për te patur diskriminim pavarësisht formës ne te cilat mund te shfaqej shkak abuziv

Sipas neni 3 paragrafi 2 te ligjit nr. 1 0221 date 04.02.2010 " Për Mbrojtjen nga diskriminimi "është përcaktuar qarte se; "Diskriminimi i drejtpërdrejtë është ajo forme diskriminimi qe ndodh kur një person apo grup personash trajtohen ne mënyrë me pak te favorshme sesa një

person tjetër , apo një grup personash ne një situatë të njëjta a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji .

Neni 7 I këtij ligji parashikon se çdo veprim i autoriteteve publike që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grup personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme në krahasim me personat e tjerë ose grupe të tjerë personash përben diskriminim.

Gjykata cmon se tarifa e pastrimit për vitet 2011, 2012, 2013 ndaj pales paditese Albchrom shpk është vendosur nga pala e paditur Keshilli Bashkiak Bulqize në përputhje me ligjin dhe Brenda kompetencave të tij. Kjo takse është vendosur ndaj pales paditese duke patur parasysh sipërfaqen e zene nga ajo për ushtrimin e aktivitetit të saj tregtar.

Gjykata cmon se kjo tarifë jo vetëm që nuk është diskriminuese por ajo është një tarifë lehtësuese e cila në bazë të ligjit nenit 32 të ligjit nr 9632 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" dhe aneksit 6 që i bashkangjitet këtij ligji duhet të ishte disa here më e lartë se ajo që është parashikuar në vendimet e Keshillit Bashkiak Bulqize. Pala paditese nuk provoi përpara gjykates që subjektet e tjera që ushtrojnë të njëjten veprimtari me të, të jenë në të njëjtat kushte apo në kushte të ngjashme me palen paditese, pra të kenë në shfrytëzim të njëjta sipërfaqe shfrytëzimi dhe kushtet në të cilat ato punojnë të jenë të njëjta . Sipas pohimeve në seance gjyqësore të perfaqësueses së pales paditese kjo tarifë pastrimi është caktuar duke patur parasysh sipërfaqen e zene për shfrytëzim nga ana e pales paditese e cila shfrytëzon një sipërfaqe me të madhe se subjektet e tjera që operojnë në këtë fushë, pohime të pales së paditur nuk u kundërshtuan nga ana e perfaqësuesit të pales paditese

...Gjykata cmon se pala paditese nuk provoi përpara gjykates që demit është real që pala e paditur Keshilli Bashkiak Bulqize të ketë vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe me faj , lidhjen shkaksore ndërmjet fajit dhe pasojës së ardhur pra nga veprimet e kundërligjshme të të paditurit Keshilli Bashkiak Bulqize të ketë ardhur demit të pales paditese si pasojë e diskriminimit . Sa më sipër gjykata cmon se në veprimet e Keshillit Bashkiak Bulqize në përcaktimin e tarifës së pastrimit ndaj pales paditese shoqëria Albchrom shpk nuk ka elemente të diskriminimit për kundërshtuar pala paditese është toleruar nga pala e paditur Keshilli Bashkiak Bulqize në përcaktimin e tarifës së pastrimit.

Përsa i përket pretendimit të perfaqësuesit të pales paditese për pagimin e demit moral në vlerën 1.770.000 leke, gjykata cmon se ky pretendim është i pabazuar në ligj.

Neni 625 i K.C. përcakton se personi që shkakton një dem, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

a) ... është cenuar në nderin e personalitetin e tij.

Në këtë rast ligjëvesësi ka parasysh që veprimi i jete i kundërligjshëm dhe me faj, në drejtim të cenimit të nderit dhe personalitetit të personit të demtuar. Përcaktimi i tarifës së pastrimit nga ana e keshillit Bashkiak Bulqize është bërë në përputhje me ligjin dhe brenda kompetencave të tij. Pra në veprimet e të paditurit nuk kemi ndonjë veprim që me faj të ketë cenuar personalitetin e paditesit .

Se fundi gjykata cmon se padia nuk ka legjitimitet pasiv përse i përket të paditurit Bashkia

Bulqize pasi sic rezultoi gjate gjykimit tarifa e pastrimit eshte vendosur nga ana e Keshillit Bashkiak te Bashkize Bulqize i cili ehste nje organ i ndryshem nga Bashkia Bulqize qe ka per kompetence ppercaktimin e tarifes se pastrimit ...”

Në ankimin e saj kundër këtij vendimi pala paditëse pretendon për gjykimin e çështjes në kundërshtim me provat dhe përcaktimet e ligjit nr 10221 date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”.

Pala paditëse shprehet në ankim se në gjykimin e kësaj çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka zbatuar konform përcaktimit të bërë në nenin neni 36, pika 3 dhe 4 e ligjit sipas të cilit: *”3. Gjykata e njofton komisionerin per paraqitjen e çdo padie per diskriminim. 4. Gjykata mund t'i kerkoje komisionerit, ne çdo faze te procedimit, qe te paraqese nje mendim me shkrim, rezultatet e hetimit te tij, ne qofte se eshte here hetimi, ose çdo informacion tjetër qe ka rendesi per çeshitjen.”*

Sipas palës paditëse, Njoftimi i Komisionerit, sipas dispozites me siper, eshte i detyrueshem dhe nuk lihet ne çmimin e gjykates. Madje edhe marrja e mendimit te Komisionerit eshte nje domosdoshmeri per sa kohe qe ai eshte organ posaçerisht i specializuar ne trajtimin e rasteve te diskriminimit dhe raste te tilla jane te reja per sistemin gjyqësor.

Në vijim të kundërshtimit të ligjshmërisë së këtij vendimi, pala paditëse shprehet se vlerësimi i provave dhe cilësimi i objektit të mosmarrëveshjes nuk është analizuar drejt nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pasi, nuk evidenton qartë dallimin midis taksës vendore dhe tarifës vendore, në mënyrë të gabuar përfundon se pala paditëse është favorizuar në masën e pagimit të kësaj taksë, i padituri nuk ka provuar se ofron shërbimin kundrejt të cilës kërkon pagimin e tarifës së pastrimit, ky shërbim realizohet nga pala paditëse nëpërmjet nënkontraktorëve të tij. Gjykata nuk ka vlerësuar drejt sjelljen diskriminuese të administratës tatimore vendore ndaj paditësit, aktet normative të anës së paditur kanë vendosur pagimin e tarifës së pastrimit në mënyrë nominale për paditësin, vlerë e cila ka ardhur duke u rritur, cka përbën një provë më shumë për ekzistencën e diskriminimit dhe thellimin e tij nder vite

Kolegji Administrativ i Apelit në shqyrtim të rrethanave si më sipër, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve dhe rrethanave konkluduar në përfundim, çmon të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në kushtet e nenit 51/1/c te Ligjit nr. 49/2012 sipas te cilit percaktohet se:

*1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:
c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.*

Kolegji vlerëson të nevojshëm debatin gjyqësor të palëve në lidhje me cilësimin e paditësit të veprimeve të palës së paditur si diskriminuese në përcaktimin e tarifës së pastrimit në vendimet për miratimin e paketës fiskale për vitet 2010, 2011 dhe 2012. Në këtë vlerësim Kolegji mori në konsideratë përcaktimet e ligjit nr 10221 date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi” si dhe mjetet mbrojtëse që garanton për mbrojtjen nga diskriminimi përfshi rrugën gjyqësore.

Pasur parasysh natyrën e shkeljeve ligjore të pretenduara nga paditësi si dhe garancitë

kushtetuese që afirmohen në ligj. Kolegji cmoi të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe njoftimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Mbi keto vleresime, Kolegji cmon se duhet të shqyrtoje çështjen në seancë gjyqësore.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 51, pika 1 germa "c" të Ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative",

VENDOSI

1. Shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.
2. Seanca gjyqësore caktohet me dt. 14.04.2016 ora 12:00
3. Urdhërohet sekretaria gjyqësore të kryejë veprimet për njoftimin e palëve me këtë vendim, datën dhe orën e seances gjyqësore.
4. T'i komunikohet ky vendim Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Tiranë, sot më 23.03.2016.

ANËTARE
Altina NASUFI

SEKRETARE

ANËTARE
Rilinda SELIMI

KRYESUES
Kastriot SELITA

